

## STATUTI

### I Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "TOWER2-NETWORK-SERVICES AL" shpk

Personat që firmosin si me poshtë:

- Bajram Sadik Durrsi, lindur me date 20.04.1984, në Kamëz, Shqipëri dhe banues në Laknas, Kamëz, Tirane, mbajtes i kartes me ID numer I40420133I.
- Genci Bajram Shemeti, lindur me date 26.05.1976, në Kamëz, Shqipëri dhe banues në Laknas. Kamëz, Tiranë, mbajtes i kartës me ID numer H60526119N.
- Në baze te Ligjit nr 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ", krijojnë Statutin e Shoqërisë.

#### KREU 1

**Themelimi, Forma, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia.**

#### Neni 1

**Data e Themelimit, Forma, dhe Themeluesit.**

- (1) Sot me datë 08.10.2024, ne themeluesit, kemi vendosur, të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ", dhe aktet e tjera nënligjore që janë ne fuqi.
- (2) Shoqëria është një person juridik Shqipëtar, i cili do të ushtroje aktivitetin privat ne territorin e Republikës së Shqipërisë, pas regjistrimit ne QKB.
- (3) Themelues të Shoqërisë janë;
  - Bajram DURRSI, me ID I40420133I, atesia SADIK, i datëlindjes 20.04.1984, me adrese Nj. Administrative Laknas, Bashkia Kamëz, Tiranë.
  - Genci SHEMETI, me ID H60526119N, atësia BAJRAM, i datëlindjes 26.05.1976, me adrese Nj. Administrative Laknas, Bashkia Kamëz, Tiranë

#### Neni 2

#### Emertimi

Emri i Shoqërisë është "TOWER2-NETWORK-SERVICES AL" shpk.  
Emri tregëtar i shoqërisë do të jetë "TOWER2-NETWORK-SERVICES AL",

#### Neni 3

#### Objekti

Instalim dhe mirembajtje antenash celulare dhe tv. Montim-çmontim konstruksione metalike. Punime elektrike. Import-eksport makineri te ndryshme industrial. Punime montim dhe mirembajtje fibra optike. Transport malli dhe materiale per nevojat e vetë subjektit.



#### **Neni 4** **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërise, do të jetë e pakufizuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë me vendim të asamblesë së Ortakeve.

#### **Neni 5** **Selia**

- (1) Selia e Shoqërise ndodhet ne adresën; *Rruga "Abaz Ermenji", Pallati Miketa 2000, Hy nr 1, Ap 12, Unaze e re, Tirane.*
- (2) Adresa e faqes zyrtare te Internetit eshte: [tomi.durrsi18@gmail.com](mailto:tomi.durrsi18@gmail.com)
- (3) Adresa e Shoqërise, per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon; [tomi.durrsi18@gmail.com](mailto:tomi.durrsi18@gmail.com).

#### **Neni 6**

Shoqëria ka vulen e saj, ku jane të përcaktuara inicialet e emërimit të saj, NIPT-i dhe adresa bazë.

#### **KREU II**

#### **Kapitali**

#### **Neni 7** **Kapitali Themeltar**

Kapitali fillestar, njëkohesisht dhe Kapital Themeltar i Shoqërise është; 1000000 (nje milion) leke, i ndare ne 2 (dy) kuota me vlerë nominale përkatësisht, 500000 lekë njera kuote dhe 500000 leke kuota tjetër.

Kapitali Themeltar përbehet nga kontribute ne vlere monetare shuma 1000000 (nje milion) leke.

#### **Neni 8**

Pjesemarrja e Themeluesve ne Kapitalin Themeltar te Shoqërise është në përputhje me kontributet e meposhtme;

- Ortaku Themelues, Bajram DURRSI, zotërues i 1 ( nje ) kuote me vlere te përgjithshme; 500000 leke, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.
- Ortaku Themelues, Genci SHEMETI, zotëruese e 1 ( nje ) kuote me vlere te përgjithshme; 500000 lekë, që përbën 50 % të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

#### **Neni 9**

#### **Zmadhimi dhe zvogelimi i Kapitalit.**

Kapitali i Shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve te pjeseve te Kapitalit Themeltar per kontributet ne para dhe kontributet ne natyre, gje e cila arrihet nepermjet

emërimin në rrugë ligjore të një eksperti të autorizuar, për keto kontribute sipas kërkeses se paraqitur nga nje person I autorizuar nga te gjithë ortaket.

Ne asnje rast, shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e Shoqërise.

Zvogelimi i Kapitalit, lejohet nga Asambleja e Ortakeve, e cila merr vendime në te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e Statutit.

Në të gjitha rastet, zvogëlimi i prek ortaket në të njëjtën masë ndaj pjeseve të kapitalit që përfaqesojne.

## **Neni 10**

### **Transferimi I Kapitalit**

Kuatat e Kapitalit ne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar, si dhe te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen, apo kalohen nëpërmjet;

- a. Kontributit në kapitalin e Shoqerise
- b. Shitblerjes
- c. Trashëgimisë
- d. Dhurimit
- e. Marrëveshje mes ortakeve, ose marrëveshje te reja mes tyre.
- f. Çdo menyre tjeter e parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar, janë lirisht te transferueshme ndërmjet ortakëve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne Statut.

Pjeset e Kapitalit Themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashëgimie.

## **KREU III**

### **Organet vendimarrëse dhe drejtuese**

## **Neni 11**

### **Organet Vendimarrëse**

Asambleja e Ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i Shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve, është organi I vetëm vendimarrës i Shoqërisë që miraton çdo ndryshim të Statutit, sipas modaliteteve të përcaktuara me ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve është pergjegjese për marrjen e vendimeve për Shoqërine per çeshtjet e meposhtme;

- Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise.
- Ndryshimet e Statutit.
- Emerimin dhe shkarkimin e Administratoreve.
- Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe Eksperteve Kontabel te Autorizuar.
- Përcaktimin e shperblimeve per Administratoret, Likujduesit dhe Ekspertet Kontabel te Autorizuar.
- Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire edhe paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve per ecurine e veprimtarise.

- Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit.
- Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- Përfaqesimin e Shoqerise ne Gjykata te te gjitha niveleve si dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratoreve
- Përfaqesimin e shoqerise ne marrëdhëniet me Organet e Qeverisjes Qendrore dhe Lokale.
- Riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise.
- Miratimin e rregullave proceduriale per thirrjen dhe zhvillimin e Mbledhjeve te Asamblese se Ortakeve.
- Çështje te tjera te parashikuara nga ligji apo nga Statuti.

Një Ortak mund të përfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te nje autorizimi, nga nje Ortak Tjeter, apo nje person i tretë. Administratori i Shoqerise (në rastin kur nuk eshte Ortak), nuk mund të veproje si përfaqësues i ortakeve ne Asamblene e Pergjithshme. Autorizimi i përfaqësimit mund te jepet vetem për një mbledhje Asambleje të pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 12**

##### **Mënyra e thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Pergjithshme të Ortakeve**

- (1) Asambleja e Pergjithshme thirret nëpërmjet njoftimit me shkresë ose, nëse parashikohet nga Statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë, apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë; vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Ky njoftim duhet t'u dërgohet të gjithë ortakeve jo me vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.
- (2) Kur Asambleja e Pergjithshme nuk është thirrur sipas pikes 1 te këtij neni, ajo mund të marre vendime të vlefshme vetem nëse te gjithë ortaket jane dakort, për të marre vendime pavarsisht parregullsise.

#### **Neni 13**

##### **Kuorumi.**

- (1) Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojne nje shumice te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 30 ( tridhjetë ) per qind te kuotave.
- (2) Ne rastin kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per çeshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87, te ligjit " Për tregetaret dhe Shoqerite tregetare ", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numerit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkresë,apo mjete elektronike,sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

- (3) Nëse Asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 dite, me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 14**

##### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katertat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakeve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakeve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve,
- c) Emerimin e shkarkimin e likujdësve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar,
- d) Percaktimin e shpërblimeve,
- e) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) Përfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve,
- g) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese,

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet në QKB, duke pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

#### **Neni 15**

##### **Perjashtimi nga e drejta e votes**

1. Ortaku nuk mund të ushtroje të drejtën e votës nëse Asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) Vleresimin e veprimtarisë së tij,
  - b) Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij,
  - c) Ngritjen e një padije ndaj tij nga shoqëria,
  - d) Dhënjen ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku perfaqësohet nga një perfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si edhe ortaku që perfaqëson.

#### **Neni 16**

##### **Administrimi**

- (1) Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emerimit është 5 vjet, me të drejte ripërteritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratoret e një shoqërie tregtare mëmë, sipas percaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emrohen si administratore të një shoqërie të kontrolluar

anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me keto dispozita është i pavlefshëm.

- (3) Personat e mëposhtem caktohen si Administratore të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblese së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(mbiemrat, emrat, adresat)

dhe specifikimet e nënshkrimit:

• Genci SHEMETI \_\_\_\_\_

me ID H60526119N \_\_\_\_\_

Atesia; BAJRAM.

Datelindja: 26.05.1976 , me adrese Nj. Administrative Laknas, Bashkia KAMËZ,  
Tirane.

## Neni 17

### Kompetencat e Administratoreve

Administratoret kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.
- Përfaqësojnë Shoqërinë tregtare.
- Kujdesen për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë.
- Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asamblese së përgjithshme për miratim.
- Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercënojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- Kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për Qëndren Kombëtare të Regjistrimit.
- Raportojnë përpara asamblese së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçante për veprimtarinë e Shoqërisë tregtare.
- Kryejnë detyra të tjera të percaktuara me ligj dhe me statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asambletë e Përgjithshme në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 10 % të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.
- Shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 10 % të asetëve të Shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 18**

### **Përgjegjësia e e administratorit**

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të tremeve, për shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe i sjellin dëm Shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te përballuar në mënyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit " Per Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", administratori detyrohet;
  - a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut, me mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
  - b. Te ushtroje kompetencat qe I njohen me ligj dhe me Statut, vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
  - c. Të vleresoje me përgjegjesi çështjet per të cilat merret vendim.
  - d. Të parandalpje dhe menjanoje rastet e konfliktit , prezent, apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqërisë.
  - e. Të ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
3. Nese, Administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
4. Në mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare ", kryen veprimet e meposhtme:
  - U kthen ortakeve kontributet
  - U paguan ortakeve interesa apo dividente
  - U shperndan aktivet e Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme, mund te shkurtoje administratorin, ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e Administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore te punes, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## Neni 18

### Përgjegjësia e e administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj Shoqërisë ose ndaj të treteve, për shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te Shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga Asambleja, qe i sjellin dëm Shoqërise, i ngarkohen administratorit dhe Ortakut qe ka bere marreveshjen, per te përballuar në mënyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat ekonomike perkatese.

1. Përveç sa është parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 te ligjit " Per Tregëtarët dhe Shoqerite Tregtare ", administratori detyrohet;
  - a. Te kryeje detyrat e tij te percaktuara me ligj dhe ne statut, me mirebesim e ne interesin me te mire te Shoqerise ne teresi, duke I kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjedis.
  - b. Te ushtroje kompetencat qe I njohen me ligj dhe me Statut, vetem per arrijten e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita.
  - c. Të vleresoje me pergjegjesi çështjet per të cilat merret vendim.
  - d. Të parandalpje dhe menjanoje rastet e konfliktit , prezent, apo te mundshem, te interesave personale me ato te Shoqërise.
  - e. Të ushtroje detyrat e tij me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem.
2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj Shoqerise per çdo veprim apo mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e Shoqerise Tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer me mirebesim.
3. Nese, Administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale sipas pikave 1 dhe 2 te ketij neni, eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje çdo fitim personal, qe ata apo, personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt, e sipas standarteve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj Shoqerise ne menyre solidare.
4. Në mënyre te veçante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte I detyruar t'i demshperbleje Shoqerise demet e shkaktuara nese, ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr 9901, date 14.04.2008 " Për Tregëtarët dhe Shoqerite Tregëtare ", kryen veprimet e meposhtme:
  - U kthen ortakeve kontributet
  - U paguan ortakeve interesa apo dividente
  - U shperndan aktivet e Shoqerise



- Lejon që Shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që Shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet.
- Jep hua.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditesit kanë të drejtë të njëkin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë përfshirë edhe demshperblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblese nuk mund të pengojë ngritjen e kerkese padise kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyres.

#### **KREU IV**

##### **Viti financiar – ekspertet**

###### **Neni 19**

###### **Viti financiar**

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përkrahimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

###### **Neni 20**

###### **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë, i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollat periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë reale ortakeve për të shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

###### **Neni 21**

###### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b) me vendim të Asamblese së Ortakeve,
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit,
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendren Kombëtare të Biznesit"

e) me vendim te gjykates. Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne te cilen parashikojne menyren e likujdimit te shoqerise,duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likujdim e siper".Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjendjen e aftesise paguese,me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

- Likujdimi kryhet nga likujduesit e emeruar nga ortaket.

Nese ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likujduesve,brenda 20 diteve kalendarike, pas prishjes,cdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykates,per te caktuar nje likuidues.

## **Neni 22**

### **Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve,ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Për Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

## **Neni 23**

### **Baza Ligjore**

Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

## **Neni 24**

### **Mosmarreveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti,si dhe per vdo mosmarreveshje qe mund te linde mes Shoqerise dhe te treteve,do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

## **ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**ORTAKU**

**Bajram DURRSI**

*Bajram Durrsi*



**ORTAKU**

**Genci SHEMETI**

*Genci Shemeti*

